



Primitur / Received	Datë / Date	11.02.2021	1	viti / god / year
Organ / Institution / Org. Unit	No. Prot. / Prot. No.	SHKIMSHICK 602/2021	Shtesa / Protog. / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
				113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A. Nr. 424/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare Arben Mehmeti dhe Jeton Koci, anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A. Nr.424/2020 të datës 17.12.2020, të parashtruar nga [redacted] me adresë banimi „Vëllezërit Gërvalla”, Nr.160, Komuna e Ferizajt, kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës, në çështjen juridik „kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 10.02.2021, mori këtë;

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A. nr.424/2020, e datës 17.12.2020, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër KA.Nr.30/2020 i datës 13.11.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] Operator Teknik i Teknologjisë Informative në Gjykatën Themelore në Ferizaj, me datë 17.12.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3186 të regjistruar me A.nr. 424/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me numër 30/2020 të datës 13.11.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pran Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 24.12.2020, ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Këshilli me datë 12.01.2021 ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Bazuar në nenin 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kryetari i Këshillit më datë 01.02.2021, ka nxjerr Vendimin VK.nr.11/2021 përmes të cilit ka vazhduar afatin e vendosjes edhe për dhjetë (10) ditë pune, lidhur me ankesën Nr.424/2020.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.424/2020, e datës 17.12.2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 13.11.2020, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; kërkesën e datës 18.02.2020; kërkesën për avancim ose transferim të datës 04.05.2020; e-mailin e datës 20.06.2020; e-mailin e datës 15.09.2020; Akt Emërimit të datës 14.05.2013; Ankesën e datës 14.10.2020, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Përgjigjen në ankesë e datës 12.01.2021.

Kolegji pas konstatimit se janë plotësuar të gjitha kushtet për pranushmerinë e ankesës si dhe pas ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit _____ është e pa bazuar sepse:

Duke ju referuar Aktgjykimin të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.AGJ 1583/20 në rastin Nr.KO203/19 të datës 09.07.2020, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji me rastin e shqyrtimit të ankesës mori parasysh konstatimet sipas pikës II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe si rrjedhojë konstatoj se deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, në raport me institucionet sipas pikës III të aktgjykimin, do të zbatohet Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil si dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra për zbatimin e tij.

Bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Akt Emërimit me Nr.protokolli 121 të datës 14.05.2013, Kolegji ka konstatuar se ankuesi mban pozitën e Operatorit Teknik të Teknologjisë Informativë, me koeficient të pagës shtatë (7) në Gjykatën Themelore në Ferizaj.

Me datë 04.05.2020 ankuesi i është drejtuar udhëheqësit të tij të drejtpërdrejt me kërkesë për avancim ose transferim nga pozita e Operatorit Teknik, në pozitën e Zyrtarit të IT-së. Ndërsa me datë 20.07.2020 ankuesi me kërkesë të njëjtë i është drejtuar edhe U.d Drejtorit të Departamentit të Administratës së Përgjithshme të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

U.d Drejtori i Departamentit të Administratës së Përgjithshme pran Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përmes e-mailit të datës 15.09.2020 ka njoftuar ankuesin se pozita e Operatorit Teknik të IT-së dhe pozita e Zyrtarit të IT-së nuk janë të njëjta për nga pozita funksionale dhe grada, përshkrimi i detyrave të punës, kushteve të punës si dhe shtesave në pagë, andaj, avancimi sipas kërkesës suaj rregullohet me Rregulloren Nr.21/2012 për Avancim në Karrierë të Nëpunësve Civilë, dhe se në një kohë të përshtatshme Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës do të procedoj publikimin e konkurseve në pajtim me aktet ligjore në fuqi.

Kundër përgjigjes së U.d Drejtorit të Departamentit të Administratës së Përgjithshme, ankuesi me datë 14.10.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pran Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave përmes Vendimit KA.nr.33/2020 të datës 23.12.2020, ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datë 29.12.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,

me pretendimin se kërkesa e tij për avancim në pozitë është e bazuar dhe se i njëjti i plotëson të gjitha kushtet e parapara me ligj, duke deklaruar me tej se Vendimi me numër KA.nr.30/2020 i datës 13.11.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave është marrë më shkelje të procedurës, me vërtetim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, ka analizuar dispozitat e nenit 26 dhe 27 të Ligjit Nr.03L/L-149 për Shërbimin Civilë, dhe ka konstatuar se avancim nga një kategori me e ulët në një kategori me të lartë funksionale apo nga një gradë më e ulët në një gradë me të lartë brenda kategorisë së njëjtë funksionale, behët vetëm pas konfirmimit të disponueshmerinë se vendeve të lira nga organi i punësimit dhe pas organizimit të një procesi të drejtë të konkurrimit bazuar në parimet e meritës, aftësive profesionale dhe përvojës së punës.

Ndërsa Rregullorja Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil, ka përcaktuar kriteret dhe procedurat për avancimin në karrierë të nëpunësve civilë, ku me nenin 9 të kësaj rregullore përcaktohet se: 1.Kriteret për avancim në karrierë të nëpunësit civil janë: 1.1. kalimi i kohës minimale në gradën e tyre ekzistuese në bazë të rregullave të përcaktuara më këtë Rregullore; 1.2. plotësimi i kërkesave profesionale dhe kualifikimet e kërkuara për pozitën përkatëse; 1.3 kalimi me sukses të testimit me shkrim dhe me gojë; 1.4. rezultatet e vlerësimit në punë të jenë: mirë, shumë mirë ose shkëlqyeshëm; 1.5. të mos jetë në procedurë disiplinore; 1.6. të mos jetë i ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore në 3 vitet e fundit; 1.7. të mos jetë iniciuar ndonjë procedurë penale, ndërsa me nenin 10 përcaktohet se: Koha minimale për avancim nga një gradë më e ulët në një gradë më të lartë ose nga një kategori funksionale më e ulët në kategorinë funksionale më të lartë, është 3 vite kur performanca e nëpunësit civil është vlerësuar mirë dhe shumë mirë, ndërsa 2 vite kur performanca e tij/saj është vlerësuar shkëlqyeshëm, kështu që duke u bazuar në konstatimet si me lartë, Kolegji vlerëson se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe në këtë mënyrë ka zbatuar drejtë dispozitat materiale lidhur me çështjen ankimore, dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar.

Bazuar në këto rrethana, e duke mbështetur ne nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe bazuar në kompetencën e Këshillit, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda me numër A.nr.424/2020

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi,

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së